

RELACION

TEKNIK

Rikualifikimi urban i fshatit Theth

06/12/17

1.-Qëllimi i projektit të propozuar

Qëllimi kryesor i projektit është rikualifikimi urban i qendrës së Fshatit Theth. Projekti ka për qëllim të rikuperojë mundësitë dhe të zhvillojë jetën e banorëve, gjithashtu edhe për të menaxhuar fluksin e vizitorëve gjatë sezonit turistik.

Ndërhyrjet e rikualifikimit, përmes peisazhit, dizajnit arkitektonik duhet të çmojnë prosperitetin e jetesës në një bllok të vogël me vlerat e së shkuarës dhe të plotësojë njëkohësisht standartet europiane në përputhje me vendndodhjen.

Thethi mbetet i izoluar. Zona është e aksesueshme nga një rrugë e pashtuar 16km e gjatë, prej fshatit Bogë, e cila është e pakalueshme gjatë muajve të dimrit dhe në përgjithësi jo e përshtatshme nëçdo periudhë të vitit për të gjitha llojet e automjeteve.

Edhe pse ligji i Kanunit mbetej në fuqi në këtë pjesë të Shqipërisë, Thethi nuk ka vuajtur nga fenomeni i rishfaqur i gjakmarrrjes pas periudhës së komunizmit. Megjithatë në Theth ndodhet një Kullë Ngujimi, ndër të paktat të mbetura, një formë mbrotjeje e familjeve që ishin "në gjak".

Largimi i popullsisë është një sfidë prej shumë kohësh për komunitetin. Popullsia është reduktuar shumë dekadat e fundit dhe shumica e tyre qëndrojnë në Theth vetëm gjatë muajve të verës. Megjithatë, komuniteti ka një shkollë 9-vjeçare dhe së fundmi janë bërë përpjekje për të stimuluar turizmin. Shumë familje lokale ofrojnë ambientet e tyre për fjetje, për ata që vijnë në Theth për të eksploruar Parkun Nacional ose admiruar vetëm natyrën.

Përveç Kullës së Ngujimit, pika të tjera interesi janë dhe ujëvarat, një mulli uji (i cili përdoret akoma nga banorët për të bluar misrin) dhe një muze etnografik modest.

Janë dy projekte që po zhvillohen në afërsi, me qëllim për të përmirësuar dhe ndihmuar infrastrukturën turistike në zonë. Balkans Peace Park Project po punon për krijimin e një parku që shtrihet jashtë kufijve të Shqipërisë, në Mal të Zi dhe Kosovë dhe ka nxitur vitet e fundit zhvillimin e një turizmi ekologjik dhe të qëndrueshëm në Theth dhe më gjerë (si psh duke financuar shënjimin e rrugëve të kalimit). Project Albanian Challengeka ndërtuar një urë të re, e cila lidh Thethin me ujëvarat e Grunasit mbi lumin Nanrreth. Projekti ka përmirësuar shënjimin e shtigjeve për në Curraj i Epërm dhe ka shënuar rreth 80km shtigje të reja pranë luginës duke krijuar një hartë të levizjës së lirë në zonë.



Lock-in Tower of Thethi



Grunas waterfall



Thethi Blue Eye

2-Harta e gjendjes ekzistuese




Theth village orthophoto

Alpet shqiptare janë një destinacion i rëndësishëm turistik i njohur ndërkombëtarisht. Kombinimi i burimeve dhe bukurive të natyrës me traditën e mikpritjes së komunitetit lokal janë kapacitetet më të mëdha të zhvillimit të turizmit në këtë rajon.

Natyra dhe peisazhi janë një potencial shumë i madh. Thethi është një parajsë për njerëzit që duan të eksplorojnë zona të pashkelura më parë. Burimet natyrore të zonës kanë mbetur të paprekura nga aktiviteti njerëzor. Klima është shumë e përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Territori është i larmishëm. Një hapësirë të vogël gjeografike mund të përjetosh njëkohësisht dhe kodrat, hapësirat malore, fushat dhe kullotat, përrenjtë, burimet, kanionet dhe ujëvarat.

-Harta topografike e ndertuar me sistemin koordinativ Gaus Krüge



Pozicioni gjeografik dhe historia e Thethit

Thethi është një fshat i vogël në Shkodër, Shqipëri. Pas reformës territoriale u bë pjesë e Bashkisë së Shkodrës dhe është deklaruar Qendër Historike e Mbrojtur nga qeveria shqiptare. Fshati ndodhet në qendër të Parkut Nacional të Thethit, në një hapësirë me bukuri natyrore të mahnitshme.

Tradita lokale pohon një paraardhës të vetëm të përbashkët për komunitetin (Ded Nika) i cili sugjeroi që popullata të zhvendosej në Theth rreth 300 deri 350 vjet më parë për të ruajtur traditat e tyre (katolike) të krishtera.

Edith Durham në vizitën e saj në Theth në fillim të shek. XX ka thënë:

"Asnjë vend i banuar nuk më ka dhënë këtë impresion të izolimit total nga bota." Durham e ka përshkruar Thethin si "bairak" prej 180 shtëpish dhe gjithashtu vërejtë që kjo zonë ishte thuajse e çliruar nga gjakmarrja, e cila ekzistonte në malësitë e tjera rrotull.

3- Informacion për qendrat e banuara

Fshati i Thethit shtrihet në një luginë me sipërfaqe prej përafërsisht 70 ha. Në fshat ka 70 shtëpi banimi dhe 11 bujtina. Në analizën e bërë në këndvështrimin urban, vërehet se fshati karakterizohet nga një densitet i ulët ndërtimesh. Fshati shtrihet në një anë të lumit Theth në një luginë të sheshtë midis shpateve të larta malore. Lumi Thethi është një lumë malor, dhe në anët e tij janë parë gjurmët e para të erozionit. Fshati mbulohet nga një rrugë kryesore që fillon nga ura dhe hyn në fshat deri në zonën pranë Kullës së Ngujimit.

Në Theth ka disa atraksione turistike:

1. Burimi i përroit të Shtrazës ndodhet në veri të fshatit Theth. Këtu uji buron prej nëntokës në një sipërfaqe prej shumë metrash katrorë.

2. Shtëpia e Sadri Lukës në Okol, e ndërtuar në fillim të shekullit të njëzetë (sot e banuar nga Gjon Deda). Një shtëpi e madhe e ndërtuar nga një "princ" lokal, i cili mbajti një familje prej 30, 20 bagëti dhe 300 kafshë të vogla dhe ushtroi ndikim të konsiderueshëm në zonë. Salla e bukur e asamblesë ishte e destinuar për mysafirët dhe për takimet me patriarkët vendas. Një tipar interesant është një gropë e thellë në bodrum, ku patatet vendosen brenda dhe mbulohen me tokë për të parandaluar nga ngrirja gjatë muajve të dimrit. Detajet e punimit të mobiljeve në banesë dëshmojnë prosperitetin relativ të pronarit të tyre të vetëm. Kjo thuhet të ketë qënë shtëpia në të cilën shkonin shkrimtarët amerikanë Rose Eilder Lane (1920) dhe Cora dhe Jan Gordon (1925).

3. Muzeu i Etnografisë (Kulla e Lulash Keqit) është ndërtuar në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Edhe pse aktualisht qëndron i zbrazët, ekspozitat janë vendosur në Muzeun e Historisë në Shkodër nga ku mund të kthehen pa vështirësi të mëdha. Ndërtesa vetë, një kullë e fortë dhe e proporcionuar mirë, tani është në duart e pronarit dhe ka plane për të rikthyer ndërtesën e braktisur në muze. Vizitorët mund të kërkojnë çelësin nga Gjovalin Lokthi i cili jeton pranë kishës.

4. Kisha në Theth (1892), një dizajn i thjeshtë drejtkëndor me një apsid prapa korit, u vendos në pjesën më të bukur të luginës. Çelësi mund të merret nga fqinjët, edhe pse brendësia është me interes të vogël arkitektonik dhe artistik. Një numër emigrantësh shqiptarë në SHBA ofruan fonde për rinovimin e përfunduar kohët e fundit (2004-2006). Kulla u rindërtua mbi themelet ekzistuese - kulla origjinale u shkatërrua nga komunistët dhe hapësira e brendshme u konvertua në klinikë ambulatorie dhe më vonë për magazinim.

5. Kulla e Ngujimit, që daton nga shekulli i nëntëmbëdhjetë është një kullë shumëkatëshe rezidenciale ku meshkujt e shënjestruar nga hakmarrja mund t'i shpëtonin ndjekësve të tyre për disa muaj. Ndërtesa është ndërtuar nga një familje e madhe lokale dhe nuk është më në përdorim. Brendësia është e pa mobilizuar; vetëm dyshemetë prej druri dhe shkallët prej druri kanë mbijetuar.

6. Kanionet e Grunas arrihen nga rruga kryesore, ku një shteg ingushtë këmbësor të çon në një urë prej druri me lartësi marramendëse, duke dhënë pamjespektakolare të lumenjve të malit, ndërsa ajo kalon përmes luginës shumë më poshte.

7. Në anën tjetër të urës, një ngjitje 25-minutëshe në rrugën e pjerrët të çon direkt në ujëvarë mbi Grunas, e cila ka një rënie të gati 25 m.

8. Mulliri i Kolajve është një ndërtim i vogël prej druri pranë një ure, e pajisur me një kanal uji nga Thethi i lumit. Ky mekanizëm shumë i zgjuar, i admirueshëm, kontrollon kokrrat e rënies së misrit pasi ato shpërndahen në gurin e mullirit. Këto mullinjtë janë ende në përdorim gjatë muajve të vjeshtës dhe fundit të verës.

9. Mullinjtë në Ndërllysë ofrojnë një spektakël natyror unik. Këtu ujërat e "Lumit të Zi" burojnë përmes një ndërtimi në shkëmbin e gdhendur gjatë mijëra viteve. Pamja spektakolare e formacioneve të jashtëzakonshme të shkëmbinjve të butë dhe të zbehtë pasqyron një kaleidoskop ngjyrash në rrezet e shndritshme të diellit. Ura e ngushtë e drunjtë që ndodhet poshtë është restauruar kohët e fundit.

Përveç atraksioneve, qendra Theth, është e strukturuar në dy pika fokale, shkolla dhe kisha, të lidhura nga rruga e pashtuar përgjatë lumit.

Ndryshe nga fshatrat e tjerë, Thethi duket se ka një qendër "lineare".

Analiza jonë, filloi me vizita, intervista me vendasit dhe turistët, si dhe një lexim të shpërndarjes hapësinore.

Vendorët nga njëra anë kërkojnë akses më të mirë nga kalimi i Thorës, por nga ana tjetër, duke ditur vlerat e mjedisit krejtësisht natyror, janë shumë të vëmendshëm për mënyrën se si mund të sigurohet ky akses.

Ato që turistët duket se vlerësojnë më së shumti, janë përsëri vlerat e ruajtura mirë të mjedisit natyror.

Foto të gjëndjes ekzistuese:



Foto: 'Kisha e Thethit'



Foto: Pamje nga zona e lumit




Foto:Pamje nga rruga kryesore



Foto:Pamje nga lart ' Qender Theth '



Foto:Pamje nga lart ' Qender



Foto:Pamje nga lart ' Qender Theth '



Foto:Bujtina Ekzistuese



Foto:Pamje nga Kulla e Ngujimit




Foto: Gështenja në zonë



Foto:Pamje nga Kulla e Ngujimit

4-Propozimet mbi rikualifikim urban në Theth,Shkodër

MASTERPLANI PROPOZUES



A. PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES RRUGORE, SISTEMI I NDRIÇIMIT, URAT DHE PARKIMET






Figura 1 Rrjeti lidhës ekzistues.

Rrugët ekzistuese janë të pashtuara. Shtëpitë janë të shpërndara dhe jo të gjitha lidhen me rrugë të aksesueshme nga automjetet për arsye të terrenit të vështirë. Vështirësia qëndron edhe për vetë banorët sepse këto rrugë nuk mund të aksesohen me çfarëdo automjeti.

Objekti kryesor i projektit është rikualifikimi i qendrës së fshatit Theth ku rrugët luajnë rolin më të rëndësishëm në përmirësimin e jetës së banorëve, gjithashtu dhe në menaxhimin e fluksit të vizitorëve gjatë sezonit turistik.

Koncepti është që rrjeti lidhës të funksionojë si këmbësor. Automjetet do të qëndrojnë të parkuara në dy hapësirat e parkimit të menduara në hyrje tek Ura I ekzistuese dhe pranë Urës II që është propozuar të ndërtohet. Automjetet do të qarkullojnë dhe në brendësi të fshatit për të sjellë vizitorët në bujtina por edhe për t'i furnizuar ato, por lëvizja e tyre do të jetë e kufizuar. Seksioni i rrugës është zgjedhur 4m, për të limituar fluksin e madh të lëvizjeve të automjeteve. Për shkëmbimin e automjeteve është menduar zgjerimi i rrugës me xhepa 2m të gjerë çdo 50-60m në vendet ku shihet e arsyeshme.

Duke analizuar pikat e interesit në zonë është gjykuar që rrjeti rrugor kryesor është ai që fillon nga ura ekzistuese në fshat dhe përfundon tek Kulla e Ngujimit. I po të njëjtës rëndësie është dhe segmenti i rrugës së Kishës. Së fundmi do të trajtohet dhe rruga që lidh Kullën e Ngujimit me Muzeun Etnografik.

Rrugët janë zgjedhur të shtrohen me zhavorr pathet e rruges kryesore ku pjerresia nuk eshte e madhe dhe si rrjedhoje nuk kemi zhvendosje shtresash, ndersa pathet me pjerresi jane zgjedhur te shtrohen dhe me nje shtrese stabilizant 10cm siper shtreses te zhavorrit (ne kete rast shtresa e zhavorrit eshte 5 cm). Eshtë zgjedhur shtrimi me zhavorr për të patur impakt sa më të ulët ndërhyrjeje. Rrjeti rrugor kryesor zgjerohet nga aksi i rrugës ekzistuese 2 m nga çdo anë, ndërsa segmentet e tjera do të shtrohen duke ruajtur gjurmët e rrugëve ekzistuese. Fillimisht rruga do të skarifikohet dhe më pas mbi tokën e ngjeshur do të hidhet çakëll i ngjeshur dhe një shtresë zhavorri sipër. Gjithsej sipërfaqja totale e rrjetit lidhës shkon në 13144m².

Duhet theksuar se disa prej rrugëve ekzistuese nuk janë rakorduar sepse ato konturohen nga gardhet rrethuese të cilat shënojnë kufijtë e pronave të banorëve. Janë krijuar dy ishuj trafiku të gjelbëruar (në hyrje të Urës I dhe të rrugës së Kishës) dhe të konturuar me bordurë guri 10x10cm. Në këto dy ishuj propozohet dhe mbjellja e dy bredhave si dhe rrethimi i trungut të tyre me gardh druri i cili do të shërbejë edhe si maskim për panelet elektrike.



Figura 2 Rrugë lidhëse e shtëpive.



Figura 3 Rruga ekzistuese kryesore.



Figura 4 Skema propozuar e lëvizjes në zonë.

2.1 RRJETI LIDHES KRYESOR (2-2, 3-3, 4-4, 5-5, 6-6)

Duke ndjekur aksin e rrugës ekzistuese, rruga zgjerohet me 2m në çdo anë. Në çdo 50-60m janë krijuar xhepa vendshkëmbimesh për automjetet 2m të gjerë. Kështu në këto pjesë të rrugës seksioni tërthor i saj shkon 6m. Në këto segmente qarkullimi i automjeteve është më i shpeshtë. Çdo 5m rruga ka trarë tërthorë druri (20x30cm).

Në këto segmente të rrugës koshat e mbeturinave vendosen vetëm në xhepat e vendshkëmbimeve të makinave me qëllim që mos të pengojnë në qarkullimin e automjeteve. Vetëm në këto hapësira gardhi i drurit pas murit të gurit vendoset në distancë nga muri që koshi i mbeturinave i kapur në to të dalë vetëm 10cm jashtë mbi murin e gurit. Muri rrethues i gurit ka një seksion 35x90cm(40 cm mbi rrugë dhe 50 cm themel i murit të gurit) dhe gardhi i drurit është me lartësi 140cm, përveç dërrasave kryesore që ngulen në tokë që shkojnë në 190cm.




Figura 5 Prerje e rrugës, segmenti 4-4, gjerësia 4m.




Figura 6 Prerje e rrugës, segmenti 4-4, gjerësia 6m.

2.2 PERFORCIMI I RRUGES (Tombinot)

Përgjatë segmentit 4-4 rruga përshkohet nga rrjedha e lumit në dimër dhe është e nevojshme përforcimi i rrugës me tombino në dy pika të këtij segmenti. Në lindje të tombinos 2 nuk është menduar si e domosdoshme të vendoset një tombino e tretë sepse nga vizita në zonë dhe pamjet fotografike të marra duket që rrjedha e lumit nuk përbën problem. Rruga është e sistemuar dhe vendosja e një tombinoje tjetër është një ndërhyrje shumë e madhe.




Figura 7 Përforcimi i rrugës, segmenti 4-4. Tombino nr. 1.




Figura 8 Përforcimi i rrugës, segmenti 4-4. Tombino nr. 2. Path 4-4 reinforcement, tombino 2.



Figura 9 Foto e marrë në lindje të Tombino 2. Photo taken in the east of tombino 2.

2.4 SEGMENTI 7-7

Ky segment i rrugës siguron një lidhje mes dy pikave kryesore të interesit, Kullës së Ngujimit dhe Muzeut Etnografik. Rruga ekzistuese është shumë e ngushtë, me seksion nga 1-2.5m. Mund të kalohe vetëm nga këmbësorë. Rruga në njërin krah ka një kanal vaditës.

Shtrimi do të bëhet me stabilizant (10 cm) njësoj si segmentet e tjera te pierreta. Muri rrethues i gurit do të jetë 55x35cm, i futur vetëm 15cm nën tokë (dukeqense nuk kalojne makinat). Në këtë segment ndriçuesit e përdorur do të jenë muralë, të instaluar në murin e gurit. Koshat e mbeturinave vendosen vetëm në kryqëzimet me dy rrugët e tjera.




Figura 12 Prerje segmenti 7-7.




Figura 13 Prerje segmenti 7-7.

3. MOBILIMI URBAN

3.1 GARDHET RRETHUESE

Rrethimi i rrjetit rrugor do të bëhet me mure guri 40cm mbi rrugën, me seksion 35cm, me lidhje të brendshme llaç. Pas murit vendosen gardhe druri natyrale me lartësi 140cm. Çdo 1.5m listela druri 190cm të larta ngulen 50cm në tokë. Dërrasat e tjera vertikale midis, dhe dy dërrasat horizontale mbërthehen me gozhdë me njëra- tjetrën. Ky është një model gardhi i fotografuar në zonë. Në segmente të ndryshme të rrugëve ndryshon lidhja e murit të gurit me tokën siç do të shpjegohet konkretisht në varësi të rasteve më poshtë.

Materiali i drurit të gardheve

Materiali i zgjedhur për drurin e gardheve do të jetë prej pemës së bungut (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky është tipi i drurit të përdorur për gardhe në Malësinë e Shkodrës.

Gardhi tip 1 (segmenti 2-2, 3-3, 4-4, 5-5, 6-6)

Muri rrethues i gurit ka një seksion 35x90cm dhe gardhi i drurit është me lartësi 140cm, përveç dërrasave kryesore që ngulen në tokë që shkojnë në 190cm. Në xhepat e vendshkëmbimeve të makinave gardhi i drurit pas murit të gurit vendoset në distancë nga muri që koshi i mbeturinave i kapur në to të dalë vetëm 10cm jashtë mbi murin e gurit.




Figura 9 Tipi 1 i rrethimit.





Figura 10 Trare druri 20x30 cm (seg :3-3,4-4,5-5,6-6)

D1



Gardh druri (bung)
i ngulur ne toke
Wood fence (sop)
embedded in the ground

Litar gershet,
(d=3cm, l=15cm)
Plat rope

Nyje e ngecur
ne thurjen e koshit
knots and stuck
in the knit basket

Koshi i thurur
knit basket

Thurje me mështekë
Knitting with birch wood

10

5

23

D2

Leter e plastifikuar
laminated paper



Ngjites, silikon
silicone sealant

Figura 20 Detaj i fiksimit të koshit në listelën kryesore të drurit të ngulur në tokë.

RELACION URA I DHE II

Për zgjidhjen arkitektonike të urave është zgjedhur veshja me elementë të plotë druri me distancë 10-15cm larg njëri-tjetrit dhe lartësi 100cm. Përdorimi i dërrasave me përmasa të tilla është bërë për të ruajtur raportin e vertikalisitetit, që është vërejtur në gardhet e përdorura në zonë. Më poshtë po tregojmë dhe foto të gardheve autentike të zonës.

Ura e dytë do të ndërtohet në afërsi të Kullës së Ngujimit, aty ku terreni është i përshtatshëm për krijimin e hapësirës së dytë të parkimit. Duke qënë se ajo do të ketë të njëjtin funksion si ura e parë, pra do të jetë për kalimin e këmbësorëve dhe automjeteve së bashku, kemi ruajtur të njëjtin trajtim si ura e parë. Izolimi i luginës së Thethit nga vetë natyra dhe vështirësia në arritshmëri ka bërë që zona të ruajë autenticitetin e saj dhe unitetin në mënyrën e trajtimit të shtëpive të banimit dhe rrethimeve të tyre (përjashtojmë këtu disa ndërhyrje të viteve të fundit të bëra nga banorët të cilat nuk janë në përputhje me karakterin e zonës). Prandaj zgjidhjet e të dyja urave janë menduar të njëjta për të ruajtur këtë unitet.

Propozimi për zgjidhje të ndryshme arkitektonike të urës së dytë do të qëndronte nëse kjo urë do të ishte vetëm në funksion të këmbësorëve. Por, qarkullimi i automjeteve në të është i nevojshëm. Së pari, për t'u lidhur me hapësirën e dytë të parkimit dhe së dyti për të vazhduar rrugëtimin në rajonin e Ndërlyraj e më tej.




Propozimi për Urën I



Propozimi për Urën I



Figura 21 "Ura" e dytë e ndërtuar nga banorët.



Hapësira mes mbrojtjes lumore dhe rrugës kryesore do të shndërrohet në një park linear me aktivitete. Të gjitha këto hapësira rekreative, çlodhëse dhe grumbullimi do të lidhen përmes një kalim këmbësorësh prej druri i vendosur mbi zhavorr. Parku linear me vegjetacion të ri dhe ekzistues do të zëvendësojë lidhjen e dytë mes dy qendrave të interesit, sheshit multifunksional të shkollës dhe kishës.

Përgjatë kalimit të drurit dhe hapësirave të gjelbëruara, do të vendosen struktura druri, të inspiruara nga siluetat e shtëpive të Thethit, që do të përkufizojnë dhe vetë lëvizjen në park.

Hapësira qëndrimi për të ndezur zjarre, pika ku mund të lexohet apo të përdoren për të marrë rreze gjatë verës do të gjejnë përsëri vend në këto pika qëndrimi në parkun e lumit.

Mobilim urban lokal si stola druri dhe tavolina do të vendosen gjatë parkut. Këta elementë urbanë mund të pozicionohen në park sipas nevojave të vizitorëve.



Imazh renderi i kalimit të druritë përgjatë Parkut të Lumit



Imazh renderi i siluetave të drunjta pranë lumit



Imazh i parkut të lumit dhe siluetave të drunjta pranë rrugës kryesore

3. MOBILIMI URBAN NE PARKUN E LUMIT

3.1 TAVOLINA DRURI

Tavolina druri rrethore ose katrore do të realizohen me dru masiv, dimensione 60*60 ose diametër 60cm, me lartësi 55cm.



Figura 24 Referencë e tavolinave të drunjtë.

3.2 STOLA DRURI MASIVE

Parku i lumit do të pajiset me stola druri masive dhe tavolina të ngjashme me modelet autentike të fotografuara në zonë. Druri masiv me diametër 50cm do të pritët në lartësinë 45cm duke ruajtur pjesën e pasme për t'u mbështetur.



Figura 25 Foto të marra në zonë të stolave të drunjtë.

3.3 SILUETAT E DRURIT (GAZEBO)

Strukturat e drurit do të realizohen me dru masiv. Për dimensionet e sakta dhe format e tyre referojuni fotove dhe detajeve konstruktive në projektin e zbatimit.




Figura 26 Tipet e siluetave të drunjtë të shpërndara gjatë Parkut të Lumit.

3.4 KOSHASHT E MBETURINAVE

Koshi i propozuar për mbeturinat do të jetë një shportë metalike, e thurur me shkopinj druri nga jashtë. Dimensionet e një shporte janë relativisht të vogla, diametri i sipërm 55cm dhe diametri i poshtëm 30cm. Secili kosh do të ketë etikatat e përdorimit të diferencuar të mbeturinave.



Figura 27 Modeli autentik i koshit të mbeturinave të fotografuar në zonë.

Koshi do të realizohet me shkopinj druri, të cilët kanë elasticitet të lartë. Tipi i drurit për koshat do të jetë mështekna, (*Betula Pendula*). Koshi do të fiksohet me një nyje litari në listelat e drurit kryesor të ngulura në tokë. Modeli i koshit i referohet një modeli autentik të fotografuar në zonë.

Tipi i drurit të përdorur për gardhin do të jetë bung (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky dru përdoret në Malësinë e Shkodrës për gardhet rrethuese.




Figura 27' Koshi i propozuar

C. SHESHI I SHKOLLES DHE NDERHYRJA NE FASADE

1.1 VENDNDODHJA DHE FUNKSIONI

Gjatë lëvizjes në drejtim të qendrës, shkolla e Thethit është objekti i parë me funksion publik me të cilin prezantohemi pas Info-Pointit. Shkolla frekuentohet nga maksimumi 10 fëmijë, sepse vetëm 5 familje qëndrojnë në Theth gjatë gjithë periudhës së dimrit. Një pjesë e hapësirës së saj i është dedikuar Ambulancës së Thethit.

1.2 OBJEKTI I SHKOLLES

Mbi objektin e shkollës është ndërhyrë vitet e fundit, por duke mos ruajtur kodin e dizajnit në zonë. Fasada kryesore dhe dy anësoret janë suvatuar me grafiatto dhe bojatisur me ngjyrë blu, ndërsa fasada e pasme vetëm është bojatisur. Në fasadën përpara dritaret janë zëvendësuar me duralumin të bardhë, ndërsa në fasadën e pasme janë zëvendësuar pjesërisht ose çarjet janë mbyllur me tulla. Në fasadën e djathtë janë vendosur panele diellore. Çarjet janë kornizuar me gips të bardhë. Çatia është zëvendësuar me llamarinë të kuqërremtë. Kompozimi i shkollës ka qënë simetrik, përpara se në anën e djathtë të vendosej hyrja e ambulancës.



Figura 28 Foto ekzistuese të objektit të shkollës.



Figura 29 Fasadat e objektit ekzistues.

1.3 SHESHI EKZISTUES

Sheshi përpara shkollës ka disnível në lidhje me objektin. Rruga drejt hyrjes është betonuar. Ndërsa lidhja e ambulancës me sistemin realizohet me disa këmbëshkallë. Hapësira përpara shkollës është rrethuar me gardhe druri të bardhë të ulët. Në hapësirën përpara ndodhen disa bredha. Hapësira e pasme është e pastrukturuar. Në anën e djathtë sheshi kufizohet nga një rrugë e pashtuar makinash.



Figura 30 Foto e sheshit ekzistues të shkollës.




Figura 31 Planimetria e gjendjes ekzistuese.




Figura 32 Prerje e sheshit ekzistues të shkollës.

2. PROBLEMATIKAT DHE KONCEPTI I NDERHYRJES

2.1 OBJEKTI I SHKOLLES

Ndërhyrjet e mëparshme që janë bërë ne objektin e shkollës nuk janë në përputhje me arkitekturën tipike të Thethit. Ndërhyrja e parë do të jetë në fasadën e shkollës, me qëllim ruajtjen e kodit të dizajnit të zonës. Çatia e llamarinës do të zëvendësohet me çati druri (pishë) me shikulla, e cila është karakteristikë e objekteve në zonë. Kangjellat e dritareve në katin përdhe do të hiqen. Gjithë dritaret do të zëvendësohen me dritare dopio xham me kasë druri pishë të stazhonuar të trajtuar me insekticide dhe llak kundër lagështirës. Dera e shkollës dhe ambulancës do të jetë druri gjithashtu. Të katërt fasadat do të pastrohen nga vegjetacioni dhe suvatimi ekzistues dhe më pas do të suvatohen dhe bojatisen. Pllakata e emërimit të shkollës dhe ambulancës do të jetë përsëri prej druri pishë të stazhonuar të trajtuar me insekticide dhe llak kundër lagështirës, me shkrimet e gdhendura me frezë dhe e fiksuar në mur me prixhoniera.



Figura 33 Pamje të propozimit të shkollës.



Figura 34 Fasada kryesore e shkollës.



Figura 35 Fasadat e tjera

Detaji i pllakatave në fasadë SH 1:20/
Detail of wooden plaque in the facade SC 1:20




Figura 36 Detaj i pllakatës së drurit.

2.2 SHESHI I PROPOZUAR

Sheshi përpara shkollës do të funksionojë si një shesh multifunksional që do të mbledhë njerëzit dhe vizitorët në Theth. Një ndër funksionet që ai mund të marrë është reklamimi i produkteve vendase dhe punimeve tradicionale të Thethit gjatë periudhave të pikut turistik. Strukturat e drunjta (gazebot) të cilat janë propozuar gjatë Parkut të Lumit mund të montohen përkohësisht edhe në hapësirën përpara shkollës për të përmbushur funksionin e propozuar më sipër.



Figura 37 Sheshi multifunksional i shkollës. Pozicionimi i strukturave të drunjta është opsional.

Por së pari, sheshi përpara shkollës do të skarifikohet deri në kufi me rrugën kryesore, dhe në të djathtë deri në kufi me rrugën e pashtuar dytësore. Më pas mbi tokën e ngjeshur do të hidhet 25cm çakëll i ngjeshur dhe një shtresë zhavorri sipër. Hapësira e rrethuar përpara shkollës ka qënë 428m² dhe propozohet të zgjerohet në 1600m².




Figura 38 Prerje të sheshit të propozuar.




Figura 39 Prerjet e rrugëve.

Sheshi do të kufizohet në dy anët e tij me gardhin me gur dhe dru të përdorur dhe për rrethimin e të gjitha rrugëve këmbësore. Nuk do të rrethohet në drejtim të rrugës kryesore sepse objekti ndodhet në distancë 54m nga rruga dhe nuk përbën rrezik për femijët. Përveç kësaj sheshi duhet të funksionojë si një hapësirë e hapur grumbullimi për të gjithë vizitorët dhe banorët.

Shtrimi i sheshit të shkollës do të jetë i njëjtë me shtrimin e rrugëve. Eshtë zgjedhur shtrimi me zhavorr për të patur impakt të ulët ndërhyrjeje. Sheshi do të ketë dy pjerrësi në drejtim të dy rrugëve kufizuese dhe lidhja e tij me hyrjen në objekt do të bëhet gradualisht. Bredhat ekzistues do të ruhen dhe rreth tyre propozohen stola dhe hapësira qëndrimi.



Figura 40 Plani i sheshit të propozuar.

3. MOBILIMI URBAN

3.1 STOLAT ME GABION

Rreth bredhave ekzistues është propozuar të vendosen stola qëndrimi. Modeli i stolit të zgjedhur është stoli me gabion dhe i veshur sipër me listela druri për t'u ulur. Ky model stoli është lehtësisht i realizueshëm. Vetë banorët kanë zgjedhur gabionat për të devijuar rrjedhën lumore dhe mbrojtja lumore do të realizohet përsëri me gabion. Stoli do të jetë 45cm i gjerë, ndërsa lartësia varion nga 40-65cm. Në pjesën e sipërme të gabionit lidhen me tel dy binarë druri gjatësore dhe mbi to mbërthehen me gozhdë listela druri natyrale.




Figura 41 Prerje të stolit të harkuar (lart) dhe e stolit rrethor me gabion (poshtë). Sections of the gabion rock benches, the arched bench (up) and circular (down).

Stolat gabion do të mbushen me zhavorr dhe në këtë mënyrë sigurohet dhe një vazhdimësi mes shtrimit të sheshit dhe mobilimit urban. Në bredhat e veçuar, stoli do të jetë rrethor. Gabioni vendoset në pjesën e brendshme edhe për arsye konstruktive, për të mbajtur shtresat e shtrimit të sheshit. Ulja do të bëhet nga jashtë stolit rrethor.

Ndërsa rreth bredhave të cilët ndodhen të grupuar do të krijohet një hapësirë e harkuar e cila në pjesën e brendshme do të gjelbërohet, ndërsa në skaj, aty ku disnivele rritet dhe bëhet i arsyeshëm për t'u ulur do të vendoset përsëri stoli me gabion. Ulja do të bëhet nga brenda hapësirës së harkuar. Në pjesët e harkut ku nuk ka stol me gabion, hapësira e harkuar konturohet nga gurë të ngulur në tokë.

DETAJ I STOLIT SH 1:10 / BENCH DETAIL SC 1:10




Figura 42 Detaj i stolit me gabion.

3.2 GARDHET RRETHUESE

Gardhi rrethues i sheshit të shkollës do të jetë i njëjtë me gardhin e përdorur përgjatë rrjetit lidhës këmbësor 7-7 (tipi 3) në anën e majtë të sheshit pranë hapësirës së harkuar. Ndërsa në kufi me rrugën dytësore do të jetë tipi i gardhit 1, sepse rruga kufizuese kalohet nga makinat. Në fillim vendoset muri i gurit me lidhje të brendshme llaç. Pas tij ngulen 50cm në tokë listela druri 190cm të larta, çdo 1.5m. Dërrasat e tjera vertikale midis, dhe dy dërrasat horizontale mbërthehen me gozhdë me njëra- tjetrën.




Figura 43 Detaj i gardhit të propozuar të shkollës.

Materiali i drurit të gardheve

Materiali i zgjedhur për drurin e gardheve do të jetë prej pemës së bungut (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky është tipi i drurit të përdorur për gardhe në Malësinë e Shkodrës.

3.3 KOSHA TË MBETURINAVE

Koshi i propozuar për mbeturinat do të jetë një shportë metalike, e thurur me shkopinj druri nga jashtë. Dimensionet e një shporte janë relativisht të vogla, diametri i sipërm 55cm dhe diametri i poshtëm 30cm. Secili kosh do të ketë etikatat e përdorimit të diferencuar të mbeturinave.



Figura 44 Modeli i koshit autentik i fotografuar në zonë.

Koshi do të realizohet me shkopinj druri, të cilët kanë elasticitet të lartë. Tipi i drurit për koshat do të jetë mëshstekna, (*Betula Pendula*). Koshi do të fiksohet me një nyje litari në listelat e drurit kryesor të ngulura në tokë. Modeli i koshit i referohet një modeli autentik të fotografuar në zonë.

Tipi i drurit të përdorur për gardhin do të jetë bung (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky dru përdoret në Malësinë e Shkodrës për gardhet rrethuese.




Figura 45 Detaje të koshit të propozuar të mbeturinave.



Church square site plan

1. GJENDJA EKZISTUESE

1.1 HISTORIKU I KISHES

Kisha e Thethit (1892), një kompozim drejtkëndor me një apsidë pas korit, është pozicionuar në pjesën më të bukur të luginës dhe është padyshim një objekt që ia vlen për t'u vizituar. Çelësi i saj mbahet nga një banor i zonës, edhe pse interieri i saj paraqet pak interes nga ana arkitektonike apo artistike. Një numër emigrantësh shqiptarë nga SHBA kanë mundësuar fonde për rinovimin e fundit të saj (2004-2006). Kisha është rindërtuar mbi themelet ekzistuese- kisha e vjetër është shkatërruar në periudhën e komunizmit dhe interieri i saj u shndërrua në klinikë ambulatorie dhe më vonë për magazinim.

2. PROBLEMATIKAT DHE KONCEPTI I NDERHYRJES

Sheshi rrotull kishës është një hapësirë e gjelbëruar me dy pemë ahu në njërin anë. Në anën tjetër ndodhen varrezat e fshatit. Sheshi i kishës është hapësira ku është ndërhyrë më pak në projekt. Këto ndërhyrje janë:

- a. Shtrimi i rrugës kryesore me zhavorr si pjesa tjetër e rrjetit lidhës këmbësor.
- b. Fshehja e varrezave përmes gjelbërimit të lartë dhe gardheve të drurit rrethues.



Figura 46 Sheshi i kishës i propozuar.




Figura 47 Prerje e sheshit.




Figura 48 Prerje e rrugës së kishës dhe detaji i shtrimit në plan.



Figura 49 Shtrimi me zhavorr i rrugës. Foto para (majtas) dhe pas (djathtas) ndërhyrjes.




Figura 50 Shtrimi me zhavorr i rrugës. Foto para (majtas) dhe pas (djathtas) ndërhyrjes.




Figura 51 Rrethimi i varrezave me gjelbërim dhe gardhe druri. Foto para (majtas) dhe pas (djathtas) ndërhyrjes.

3. MOBILIMI URBAN

3.1 GARDHI RRETHUES I VARREZAVE

Varrezat pranë Kishës janë lënë të ekspozuara dhe prandaj lind nevoja për rrethimin e tyre me gardh si dhe izolimin me pemë. Do të përdoren bredha që qëndrojnë të gjelbër gjatë gjithë vitit si dhe shkurre trëndafili të egër.

Gardhet do të jenë prej druri, të cilat çdo 1.5m do të ngulen në tokë, ndërsa dërrsat e tjera midis si dhe dërrsat horizontale do të mbërthehen me gozhdë me të tjerat.




Figura 52 Gardhi rrethues i varrezave.

5-Përshkrime të proceseve ndërtimore dhe teknologjike.

1.1

Zëvendësimet

Zëvendësimi i materjaleve të specifikuara nëdokumentin e kontratës do të bëhen vetem me aprovimin e mbikqyrësit të punimeve nëse materjali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose me i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e kontratës për shkak tëkushteve jashtë kontrollit të sipërmarrësit.Që kjo të merret në konsideratë,kerkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi tëcilësisë,në formën e kuotimit tëcertifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materjalëve,si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

1.2

Dokumentet dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet,sasitë dhe detajet të treguara nëvizatimet, grafiqet,ose të dhëna të tjera dhe punëdhënësi nuk do të mbajë përgjesi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve, nuk do ta lehtësojë sipërmarresin nga përgjegjësia për punë të pakënaqshme. Sipërmarrësi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive tëmaterialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bere sipas kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonje gabim ose mospërputhje,ndërsa një udhëzim i plotë do tëjepet nga punëdhënësi nëse gabimet tëtilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.3

Bashkëpunimi në zone

Ndërtimi do të bëhet në zona të kufizuara.Sipërmarrësi duhet tëketëvecanërisht kujdes në:

a) nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës sëndërtimit.

b)prezencën e mundshme tëkontraktorëve të tjerë në zonë me tëcilët do të koordinohet puna

E gjithë puna,do të bëhet në një mënyrë të tillë,që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundshme për ndonjë kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij,stafin e punëdhënesit si edhe tëcdo punonjësi që mund të punësohet në zbatim dhe/ose punimet në zonë ose pranë saj për cdo objekt që ka lidhje me kontratën ose cdo gjë tjetër. Në përgatitjen e programit të tij të punës, sipërmarrësi gjatë gjithë kohës do tëbëjë llogaritë e plota dhe do të koepërojë me programin e punës se kontraktorëve të tjerë,në mënyrë që të shkaktojënjë minimumin tëreferencave me ta dhe me publikun.

1.4

Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve,tëpunësuar dhe të jetës publike si edhe të pasurive nën dhe, rreth sheshit të ndërtimit.Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme,kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe cdo rrezik do të kqyrën ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit. Gjatë zbatimit të punimeve sipërmarrësi,me shpenzimet e veta,duhet tëvendosi dhe tëmirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita tëcilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet tësigurojë pengesa të përshtatshme,shenja me dritë të kuqe “rrezik”ose “kujdes”dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnëcrregullime të trafikut normal ose që përbëjnënjë ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

A- Punimet e gërmimit

a) Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve sic tregohet nëvizatime. Cdo thellësi me e madhe e gërmuar nën nivelin e formacionit,brënda tolerancës së lejuar,duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika tëngjashme nga sipërmarresi me shpenzimet e tij.

b) Kujdesi vecantë duhet të ushtrohet kur gërmohen prerje për të mos hequr material përtej vijës sëspecifikuar të prerjës dhe më pas duke shkaktuarrrrezikshmëri përqëndrueshmërinëstrukturore të pjerrësisë ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjesevë të ngjeshura.

c) Përmasat e prerjeve duhet tëjenë në përputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen në vizatime.

2.4 Trajtimi/Ngjeshja e zonave të gërmuara

a) Zonat dhe pjerrësitë e prerjeve duhet të jenë konform me vizatimet dhe duhet të rregullohen sipas një vije të paster të standartit,për një tip të dhënë materiali.

b) Të gjitha zonat horizontale të gërmuara,duhet të ngjeshen me një minimum dendësie të thatë prej 95% për dherat e shkrifët dhe 90% për dherat e lidhur.

A.1 Gërmimi për strukturat

Gërmimi për strukturat duhet të jetë në përputhje me vizatimet. Anët duhen mbështetur në mënyrë të përshtatshme gjatë gjithë kohës. Një alternativëështë që ato mund të ngjeshen në mënyrë të përshtatshme.

Gërmimet duhet të mbahen të pastra nga uji.Tabani i të gjithë gërmimeve duhet të nivelohet me kujdes.Cdo pjesë me material të butë ose mbeturina shkëmbi në taban duhet tëhiqet dhe kaviteti që rezulton të mbushet me beton.

A.2 Gërmimi i kanaleve për tubacionet

Kanalet do të gërmohen në dimensionet dhe nivelin e treguar në vizatime ose në përputhje me instruksionet me shkrim të mbikqyrësit të punimeve. Zëri i treguar në tabelën e volumeve (Preventiv) lidhur me gërmimet ,sic është largimi i materialit të gërmuar, etj. do të përfshijëcdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jetë specifikuar ndryshe. Gërmimi me krahëështë gjithashtu i nevojshëm në afërsitë intersektive të infrastrukturave të tjera për të parandaluar demtimin e tyre. Me përjashtim të vëndeve të përmendura më sipër, mund të përdorën makineritë. Nëse nuk urdhërohet apo lejohet ndryshe nga mbikqyesi i punimeve nuk duhet të hapen më shumë se 30 metra kanal përpara përfundimit të shtrirjes së tubacionit në këtë pjesë kanali. Gjerësia dhe thellësia e kanaleve të tubacioneve do të jetë sic është përcaktuar në vizatimet e kontratës ose sic do të udhëzohet nga mbikqyrësi i punimeve. Thellimet për pjesët lidhese do të gërmohen me dorëmbasi fundi i kanalit tëjetë niveluar. Përveç se kur kerkohet ndryshe,kanalet për tubacionet do të gërmohen nën nivelit të pjesës së poshtëme të tubacionit sic tregohet në vizatime, për të bërë të mundur realizimin e shtratit të tubacioneve me materiale të granuluara

B- Punimet mbushëse

Punimet mbushëse do të realizohen në përputhje me përmasat dhe nivelet që tregohen në vizatime dhe/ose sic përcaktohen ndryshe me shkrim nga mbikqyrësi i punimeve. Punimet do të realizohen në nivelin që të kenë kërkesat e mbikqyrësit të punimeve. Materialet që do të përdoren për punimet mbushëse do të jenë të lira nga gurë dhe pjesë të forta më të mëdha se 75mm në cdo përmasë, dhe gjithashtu të pastër nga përbërës druri apo mbeturina të cdo lloji. Materiali mbushës do të ngjeshët sipas mënyrës së aprovuar.

Kanalet dhe shpatet, transhetë dhe mbushjet e rrugëve do të bëhen ngjeshën gjithashtu. Nëse nuk specifikohet ndryshe apo kërkohet ndryshe nga mbikqyrësi i punimeve, materiali mbushës dhe mbulues do të merret nga punimet e gjurmëve. Nëse mbikqyrësi i punimeve përcakton se materiali nuk është i cilësisë së duhur atëherë, do të përdoret

materiali zgjedhur i sjellë nga një zonë tjetër. Materiali i zgjedhur do të jetë homogjen dhe do të kushtohet rëndësi pastrimit nga llumrat, boshllëqet dhe cdo parregullsi tjetër. Mbushjet dhe mbulimet do të jenë në shtresëzimet e vashdieshme dhe gati horizontale për të arritur trashësinë e treguar në vizatime ose sic mund të kushtëzohet nga mbikqyrësi i punimeve. Mbulimi, në punimet e mbushjes dhe mbulimit, me materiale sipërfaqësor, nuk është i lejueshëm. Shtresa e sipërme e fundit e mbushjes dhe mbulimit duhet të mbahet në gjendje sa më të sheshtë të jetë e mundur. Në vendet ku kërkohet mbushje ose mbulim shtesë, lartësia e treguar në vizatime për mbushje dhe mbulim do të rritet në përputhje me udhëzime të dhëna.

B.1 Mbushja dhe mbulimi

Përgatitja e shtratit

Jetëgjatësia e tubacioneve Polietilenit të shtruar anë tokës, varet shumë nga cilësia e shtratit. Materiali dhe ngjeshmëria e duhur e shtratit menjanon defektet që mund të shkaktohen nga deformime të padëshiruara dhe mbingarkimet vendore. A ka nevojë për shtrat të veçantë gjykohe sipas llojit të tokës. Shtrati nuk është i nevojshëm, kur toka është e fortë, me strukturë kokrrizore, dhe $D_{max} < 20\text{mm}$ por edhe në këto raste fundi (tabani) duhet ngjeshur. Në të gjitha rastet e tjera dhe shtrati, me trashësi minimale 10 cm, në shkëmb dhe në tokë me gurë 15cm. Në tokë të disfavourshme, si tokë me shumë përmbajtje organike, që shëmbet lehtë, shtresë në nivelin e ujit freatik, në shtrat duhet projektuar edhe shtresë mbështetëse. Materiali dhe ndërtimi i saj përcaktohen veçmas për çdo rast nga projektuesi. Për shtratin mund të përdoret dhe i shkrihet dhe i ngjeshur dhe pak i lidhur, pashuka. Diametrat maksimale të grimcave:

- në rastin e tubave PVC dhe Polietilenit normale, me faqe të rrafshet: $D_{max} < 20\text{mm}$
- në rastin e tubave të lemuar $D_{max} < 5\text{mm}$

Ky material shtrati duhet vendosur në tërë zonën e tubit, deri 30cm mbi buzën e sipërme të këtit (shih projektin). Në tërë zonën e tubit hedhja dhe ngjeshja duhet të bëhen në shtresë jo më të trasha se 15cm.

Për tubat me diametër të vogël trashësia e shtresës së poshtme nuk mund të jetë më shumë se $D/2$.

Mbushja me hedhje të dheut me makineri është e ndaluar. Hedhja e dheut, lëvizja dhe ngjeshja e tij do të bëhen vetëm me dorë. Për ngjeshje rekomandohen tokmake me buzë të rrumbullakuara.

B.2 Ngjeshja

Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për qëndrueshmërinë e mbushjeve, mbulimeve dhe shtratit të tubave brenda periudhës së korrigjimit të difekteve që është përcaktuar në kushtet e kontratës.

Tolerancat në ndërtim.

Shtresa baze e përfunduar do të përputhet me tolerancat e dimensioneve të dhëna më poshtë:

(a) Nivelet

Sipërfaqja e përfunduar do të jetë brenda kufijve +15mm dhe -25mm nga niveli i caktuar, ndryshimi nga shkallëzimi i dhënë të mos kalojë 0.1% në 30m gjatësi të matur.

(b) Gjerësia

Gjerësia e shtresave të themelit nuk duhet të jetë më e vogël se gjerësia e specifikuar.

(c) Trashësia

Trashësia mesatare e materialit për çdo gjatësi të rruges nuk duhet të jetë më e vogël se trashësia e specifikuar.

C - Punimet e betonit

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston në furnizimin e gjithë kantierit, punën, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e të gjitha punimeve, në lidhje me hedhjen, kujdesin, përfundimin e punës së betonit dhe hekurin e armimit në përputhje rigoroze me këtë kapitull të specifikimeve dhe projekt zbatimin.

Në fillim të kontratës sipërmarrësi duhet të paraqesë për miratim tek mbikqyres i punimeve një njoftim për metodat duke detajuar, në lidhje me kërkesat e këtyre specifikimeve, propozime të tij për organizimin e aktiviteteve të betonimit në shesh (teren). Njoftimi i metodave do të përfshijë çështje të mëposhtme:

1. Njesia e prodhimit e propozuar
2. Vendosja dhe shtrirja e paisjeve të prodhimit të betonit
3. Metodatat e propozuara për organizimin e paisjeve të prodhimit të betonit
4. Procedura të kontrollit të cilësive të betonit dhe materialeve të betonit
5. Transporti dhe hedhja e betonit
6. Detaje të punës së përfunduar së kallojeve duke përfshirë kohën e heqjes së kallojeve dhe procedurat për mbështetjen e përkohshme të trarëve .

5.1-Materialet e perdorura

1.1 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë dërdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga mbikqyres i punimeve në çdo kohë.

1.2 Materialet :Punimet e Shtresave

Ky seksion mbulon ndërtimin e shtresave me zhavorr ose cakëll mbeturina gurore. Shtresat me zhavorr (cakëll mbeturina) 0-31.50mm (d=100mm) ose zhavorr (cakëll mbeturina) 0 –50 mm (d=150mm), do të quhen më tutje “nënshtrëse”.

Materiali i kësaj shtrese merret nga lumenjtë ose guroret ose nga burimet e tjera.

Kjo shtresë nuk do të përmbajë material që dimensionet maksimalet e tëcilit i kalojnë 50mm (trashësia e shtresës përfundimtare 100mm) ose 100mm (trashësia e shtresës përfundimtare 150mm).

Materiali i shtresës duhet të përputhet me kerkesat e mëposhtme kur të vendoset përfundimisht në vepër:

Agregatet (inertet) e përdorura për shtresën bazë të përbërë prej gurëve të thyer do të merren nga burimet e caktuara në lumenj ose gurore. Kjo shtresë nuk do të përmbajë material copëzues(prishës)si psh. pjesë shkëmbinjsh të dekompozuar ose material argjilor.

1.3 Çimento

a.Çimento Portland e Zakonshme do të përdoret me BS12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do të përdoret aty ku betoni nuk është në kontakt me ujërat e zeza,tub gazi ose ujërat nëntokësore.

b.Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do të përdoret me BS4027. Kjo do të përdoret për strukturat e betoneve duke përfshirë pusetat dhe të gjitha përkatësitë e tjera në kontakt me ujërat e zeza,tubin e gazit ose ujërat nëntokësore. Çimento duhet të shpërndahet në paketa origjinale të shënuara tëpademtuara direkt nga fabrika dhe duhet të ruhet në një depo,dysHEMEJA e tëcilit duhet të jetë e ngritur të paktën 150mm nga toka.Një sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezervë për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm në punë,në mënyrë që të sigurohet që dërgesat e ndryshme janë përdorur në atë mënyrë sic janë shpërndarë.

1.4 Stola dru masiv

Parku i lumit do të pajiset me stola druri masive dhe tavolina të ngjashme me modelet autentike të fotografuara në zonë. Druri masiv me diametër 50cm do të pritët në lartësinë 45cm duke ruajtur pjesën e pasme për t'u mbështetur.

1.5 Tavolina druri

Tavolina druri rrethore ose katrore do të realizohen me dru masiv, dimensione 60*60 ose diametër 60cm, me lartësi 55cm.

1.6 Silueta druri (GAZEBO)

Strukturat e drurit do të realizohen me dru masiv. Për dimensionet e sakta dhe format e tyre referojuni fotove dhe detajeve konstruktive në projektin e zbatimit.

1.7 Koshat e mbeturinave

Koshi i propozuar për mbeturinat do të jetë një shportë metalike, e thurur me shkopinj druri nga jashtë. Dimensionet e një shporte janë relativisht të vogla, diametri i sipërm 55cm dhe diametri i poshtëm 30cm. Secili kosh do të ketë etikatat e përdorimit të diferencuar të mbeturinave. Koshi do të realizohet me shkopinj druri, të cilët kanë elasticitet të lartë. Tipi i drurit për koshat do të jetë mëshstekna, (*Betula Pendula*).Koshi do të fiksohet me një nyje litari në listelat e drurit kryesor të ngulura në tokë. Modeli i koshit i referohet një modeli autentik të fotografuar në zonë.

Tipi i drurit të përdorur për gardhin do të jetë bung (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky dru përdoret në Malësinë e Shkodrës për gardhet rrethuese.

1.8 Materiali i drurit të gardheve

Materiali i zgjedhur për drurin e gardheve do të jetë prej pemës së bungut (*Quercus sessilis Ehrh.*) Ky është tipi i drurit të përdorur për gardhe në Malësinë e Shkodrës.

1.9 ZONAT E GJELBERTA

Zonat e gjelberta janë menduar të mbillen me bar ,per sipërfaqet e ndricuara në diell me densitet të lartë por lartësi të ulët. Plantacioni duhet të realizohet në toke të pasura me humus.

1.10 BIMET ORNAMENTALE

Për zonat e mbjella me bime ornamentale synohet të mbillet trendafil i eger.

Përgatitja e tokës:

Fidani duhet të lehtësohet dhe pastrohet nga kontaminimet.

Pas mbjelljes të fidanit , 10 cm të zhavorrit të grimcuar (16/32) do të aplikohet si një shtresë mbuluese.

Përgatitja e tokës:

Gropa duhet të pastrohet nga të gjithë ndotësit dhe agjentet kontaminues.

Mirëmbajtja e vazhdueshme:

Blloku i mbjellës duhet të mbrohet vazhdimisht dhe të shoqërohet me prerje

Vjeshta këshillohet si koha për zvogëlimin. Përveç zvogëlimit formal profesional përtëritje-zvogëlim këshillohet në cikle 2-3 vjet.

Duhet të sigurohet një ujiti e mjaftueshme, fekondimi sipas nevojës.

Trendafil i eger (*Rosa acicularis*)

lartësia : 1 - 3 m

perhapja : 0.6 - 1 m

diellzimi : Në diell të plotë, pjesërisht në hije

lageshtira : e thatë në të mesme



Figura 53

Rekomandimet e Rendesishme: – mbjellja e pemëve duhet të kryhet në periudhën nga shtatori në tetor dhe nga shkurti deri në mars.

Pemët e mbjella do të jenë pisha mesdhetare (*Abies alba mill*) $h = 10$, p (trungu) = 45cm dhe gështenja e ëmbël (*Castanea sativa Mill*) me një lartësi prej rreth 7 m dhe perimetrin e trungut rreth 40 cm. Kur transportoni pemë, jini të kujdesshëm për të mbrojtur rrënjët e tyre. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në momentin e vendosjes së pemëve në pozicionin e tyre, sepse gjatë asamblesë nuk duhet të dëmtohen as rrënjët, as trupi i pemës së bashku me kurorën e tyre. Në rast të dëmtimit të pemës do të jetë zëvendësimi i tij nga sipërmarrësi me shpenzimet e veta. Sapo pema të vendoset në pozicionin e saj, fillon hapësira mbushëse e mbushur me humus.

Geshtenja e embel Shqiptare (*Castanea sativa Mill*)

lartesi : 18 - 24 m

perhapja : 15 - 21 m

diellzim : diellzim i plote

lageshtira : e thate ne te mesme



Figura 54



Figura 55

Fir tree (Abies alba mill) height

lartesi: 40–50 metres

perhapje : 15 - 21 m

diellzim : diellzim i plote

lageshtira : e thate ne te mesme

Abies alba është një bimë e ndjeshme ndaj ndotjes dhe ndryshimeve klimatike. Për shumë kohë është përdorur si pema e krishtlindjeve, megjithatë kohët e fundit është zëvendësuar nga lloje të tjera, si psh: Picea abies. E merr emrin nga ngjyra e bardhë që ka trugu. Abies alba: bredhi me ngjyrë argjendi, është një specie me gjelbërim të përhershëm.

KARAKTERISTIKA TË PJESËVE TË VECANTA ANATOMIKE: Gjethja është në formën e një gjilpërë të rrafshët. Përmasat e gjethes janë: 1.8 – 3 cm (gjatësi), 2 mm (gjerësi), 0.5 mm (trashësi). Kanë ngjyrë të gjelbër të errët nga sipër dhe ngjyrë të bardhë në gri në pjesën e poshtme. Konet janë 9 – 17 cm të gjatë dhe 3 – 4 cm të gjerë. Ata janë të përbërë nga 150 – 200 shtresa luspash dhe secila nga luspashat përfundon me një zgjatim, në të dyja anët e secilit gjenden 2 fara. Në kohën kur farat piqen, konet shpërbëhen dhe farat largohen.

Trugu ka ngjyrë të bardhë, nga merr edhe emrin bima dhe diametri i tij shkon deri në 1.5 m. Forma e jashtme: Abies alba është një bimë halore me gjelbërim të përhershëm, me një gjatësi që arrin deri në 40 – 50 m.



Figura 56

1.12 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DRURIT

Mështekna(lat. *Betula Pendula*)

Druri i mështeknës gjen përhapje në zonën e Alpeve Shqiptare ose në zonën malore të Maleve të Sharrit. Është dru me lëvore të bardhë, diametri i trugut 40cm, me lartësi 15-25m. Gjethet 2-7cm, trekëndore ose romboide me majë të gjatë dhe të mprehtë dy herë të dhëmbëzuara si sharrë.

Ky tip druri ofron elasticitet prandaj do të përdoret për thurjen e koshave të mbeturinave si modeli autentik i koshit i fotografuar në zonë. Druri do të lihet natyral.



Gjethja e mështeknës (majtas) dhe pema e mështeknës (djathtas) Figura 57



Modeli autentik i koshave të fotografuar në Theth Figura 58

Bungu (Quercus sessilis Ehrh.)

Druri i bungut përdoret për thurjen e gardheve në Malësinë e Shkodrës. Është lloj dushku 30-40m i lartë, me trung të trashë, me kurorë të gjerë e të çrregullt, me lëkurë të murrme e me gjethe vezake. Është druri më i rëndësishëm në përdorim jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Pjesa më e fortë e drurit të bungut përdoret për gardhe, trarë çatie ose konstruksione të tjera.

Bungu konsiderohet dru i fortë, me tendencë për t'u dukur jo i lëmuar. Varieteti i përdorur në Malësinë e Shkodrës është bungu i bardhë, i cili ka një teksturë me ngjyrim gri dhe shenja të verdha. Është shumë i durueshëm dhe pritet në mënyrë të tillë që të jetë rezistent ndaj deformimeve. Ka një pamje të dallueshme prej teksturës së ashpër. Shenjat e drurit mund t'a errësojnë ose ekzagjerojnë këtë teksturë, duke u dukur me dy ngjyime.

Bungu do të përdoret për gardhet rrethuese në Theth, përgjatë rrugëve, sheshit të shkollës apo varrezave pranë Kishës. Druri do të lihet natyral, pa asnjë shtresë llaku sepse kështu është vërejtur përdorimi i tij në zonë.



Figura 59

Gjethet e bungut (majtas) dhe trugu (djathtas)



Figura 60

Gardhe të drunjtë (bung) të fotografuara në zonë

Pisha (lat. Pinus Nigra)

Pisha është pemë konifere që rritet në zonën e Mesdheut, përfshirë këtu edhe Shqipërinë. Arrin lartësi 20-55 metra me diametër kurore 6-12m. Lëvorja është me ngjyrë të verdhë në kafe dhe plasaritet me kalimin e viteve.

Druri i pishës është i lehtë dhe varion në dy ngjyime, të verdhë apo të bardhë me damarë kafë. Gjen përdorim në stilin rustik. Ndryshon me kalimin e kohës duke marrë pamje të vjetëruar. Është rezistente ndaj ndryshimit të temperaturave, duke i rezistuar tkurrjes dhe bymimit. Gjithashtu e mund të ngjyrosset lehtë.

Konsiderohet dru i butë dhe është i prirur të gërvishtet.

Banorët në Theth e kanë përdorur drurin e pishës së pari për mbulimin me shikulla të çatisë. Rezistenca ndaj kushteve atmosferike dhe pesha e lehtë e drurit e bëjnë të përshtatshme për këtë përdorim. Dhe në projektin e rikualifikimit urban, druri i pishës është zgjedhur si më i përshtatshmi, për të bërë mbulimin e çatisë së Shkollës, si dhe për realizimin e veshjes së kabinës së rojes dhe elementëve të tjerë të mobilimit urban. Trajtimi i drurit të pishës do të ndryshojë.



Figura 61

Gjethë të pishës (majtas) dhe trugu (djathtas)

a. Dru pishe i stazhionuar, i trajtuar me insekticid dhe llak kundër lagështirës dhe ngjyrim Peruvian

Në projekt ky specifikim teknik i drurit është përdorur vetëm në parapetet rrethuese të urave dhe hapësirave të parkimit. Druri i pishës së pari duhet stazhionuar në mënyrë natyrale për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër. Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- * Lagështira jo më e lartë se 7%
- * Pesha volumore rreth 450-540kg/m³
- * Kufiri i rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

b. Dru pishe i stazhionuar, i trajtuar me insekticid dhe llak kundër lagështirës.

Në çdo pjesë tjetër të projektit ku është përdorur druri i pishës (pallakata e Shkollës, veshja e çatisë, dyert dhe dritaret e reja të vendosura, veshja e objektit të rojes etj) trajtimi i drurit të pishës do të jetë si më sipër. Por, së pari pisha duhet stazhionuar në mënyrë natyrale për një periudhë minimalisht 5 vjeçare dhe të jetë trajtuar me dy duar vaj lini përpara se të montohet në vepër.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- * Lagështira jo më e lartë se 7%
- * Pesha volumore rreth 450-540kg/m³
- * Kufiri i rezistencës në tërheqje rreth 130MPa.

6-Infrastruktura e nevojshme e përdorur në projekt .

1.1 Hyrja në sheshin e ndërtimit.

Sipërmarrësi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirëmbajen dhe më pas të postojë dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvëndosja do të përfshijë përshtatjen e zonës me çdo rrugë hyrje dhe së paku me shkallë sigurie, qëndrueshmërie dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore të njëjtëme atë që ekzistonte përpara se sipërmarrësi të hynte në shesh.

1.2 Furnizimi me ujë

Uji,që nevojitet për zbatimin e punimeve, do tëmerret nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme.Sipërmarrësi do të shtrijë rrjetin e vet të përkohshëm të tubacioneve.Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot për këtë do të paguhen nga sipërmarrësi. Nërastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor,sipërmarrësi duhet të bëjë vetë përpjekjet për furnizimin me uje higjenikisht të pastër dhe të pijshëm për punëtorët dhe punimet.

1.3 Furnizimi me energji elektrike

Sipërmarrësi do të bëjë përpjekjet dhe me shpenzimet e tij për furnizimin me energji elektrike nëkantjer,si me kontraktim me KESH-in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal janë të mundura,ose duke parashikuar gjeneratorin e vet për të përmbushur kerkesat.

1.4 Piketimi i punimeve

Sipërmarrësi,me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave sic kërkohet,në përputhje me informacionin bazë të punëdhënësit,dhe do tëjetë përgjegjësi i vetëm për përpikmërinë.

6.1 - Informacion për rrugët ekzistuese të aksesit




Figura 62

Rrugët ekzistuese janë të pashtuara . Pjesërisht ashtu si janëspecifikuar edhe në projekt do të bëhet shtrimi i tyre me shtresat përkatëse të specifikuara.Rrugët brenda zonës të fshatit janë rrugë me gjerësi të ndryshme dukeqenëse janë edhe rrugë të krijuara vetë nga banorët sipas nevojave të tyre në vite.Dallojmë rrugën kryesore (linja e verdhe) që shërben për hyrjen në fshat dhe rrugët e brëndshme (linjat e kuqe) që shërbejnë për lidhjen dhe furnizimin e bujtinave ndërmjet tyre.

7 -Programi i punimeve

GRAFIKU PUNIMEVE															
TITULLI I PROJEKTIT : RIKUALIFIKIM URBAN në Theth, Shkodër															
PERIUDHA NE MUAJ															
Nr.	EMERTIMI I PUNIMEVE	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV
1	GERMIME	■	■				■	■		■	■		■	■	
2	PUNIME ELEKTRIKE		■	■	■	■					■	■			
3	MBULIMI I CATIVE		■	■	■	■					■	■			
4	PUNIME NËNSHTRESA				■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
5	RESTAURIMI I SHKOLLËS	■	■	■							■	■			
6	MBJELLJE									■	■	■	■	■	■
7	MONTIM NDRICUES, TABELA											■	■	■	■
8	SINJALISTIKA											■	■	■	■

Punimet e Rikualifikimit Urban mendohen të realizohen në një periudhë kohore prej XIV muajsh.

Germimet do të realizohen në muajt I ,VI , IX , XII

Punimet Elektrike do të realizohen në muajt II,III,IV,X,XI

Mbulimi i cative do te realizohet në muajt II,III,IV,V,XI,XII,XIII

Punime Nënshtrës do të realizohen në muajt IV,V,VI,VII,X,XI,XII,XIII,XIV

Restaurimi i Shkollës do të realizohen në muajt I,II,VII,VIII,IX,X,XIII,XIV

Mbjellje do të realizohen në muajt IX,X,XI,XII,XIII,XIV

Montim Ndricues/Tabela do të realizohen në muajt XI,XII,XIII,XIV

Sinjalistika do të realizohen në muajt XI,XII,XIII,XIV

9-Mbulimi i objekteve me cati druri

Lugina e Thethit si zone historike mjaft e vizituar nga turistet, paraqet nje nevojë për nderhyrje arkitektonike në zone me qellim ruajtjen e identitetit të zones. Një nder problematikat që vihet re në zone janë catite dhe mbulimi i tyre me elemente të ndryshëm jashtë kontekstit të zones . Nderhyrja konstaton në unifikimin e cative në zone . Te gjitha objektet e paraqitura në hartën e mëposhtme do të mbulohen me cati me shikulla . Shikullat janë elemente që nxirren nga druri i pishës që shërbejnë për mbulim dhe janë përdorur nga banorët e zones . Shikulla është një traditë ndërtimi në zonën e Alpeve të Shqipërisë, kryesisht në luginën e Thethit dhe Valbonës ndaj propozohet mbulimi i të gjitha objekteve në hartën e mëposhtme me cati me shikulla.

Nderhyrja konstaton në mbulimin e 52 objekteve me cati ekzistuese jashtë kontekstit.




Figura 64

Detaj i catisë së drurit në prerje SH 1:20
Section wooden roof detail SC 1:20

- Çati me shikulla (20 x 70 cm elementi i shikullës) / roof cover with wooden panels

- Listela druri 4x4cm/wood list 4X4cm

- Shtrese hidroizoluese me katrama/waterproofing layer

- Sip. Druri per nencatine/wood veneer for the attic
- Tra druri 10x15 cm/Wood beam 10X15cm

- Brez Druri perimetral (30x60) cm /perimeter wooden sash
- Muri ekzistues/ existing wall

Shtrese llaci per kapje




Figura 65

10-Sinjalistika : Shtigjet Theth -Valbone, Theth - Lepushe

10.1 Hartat e nderhyrjeve



Figura 66

Kalimi Theth-Valbone eshte nje rruge mjaft e preferuar dhe e vizituar nga turiste te huaj dhe shqiptare. Rruga ka nje shtrirje 12.1 km. Propozohet nje projekt i mirefillte i sinjalistikes duke rritur informacionin mbi shtegun dhe duke ulur shkallen e rrezikshmerise gjate udhetimit .



Figura 67

Kalimi Theth-Lepushë është një tjetër destinacion i preferuar dhe i vizituar nga turistë të huaj dhe shqiptarë. Rruga ka një shtrirje 17.8 km. Propozohet një projekt i mirefilltë i sinjalistikës duke rritur informacionin mbi shtegun dhe duke ulur shkallën e rrezikshmërisë gjatë udhëtimit.

1 - Tabelat informuese dhe orientuese

Tabelat informuese janë me dimensione të mëdha (450 cm:300cm), të krijuara nga një strukturë druri i kombinuar me trunjtje druri dhe panele policarbonate për vendosjen e materialit të printuar.

Tabelat orientuese janë me dimensione më të vogla, të krijuara nga një trunç druri në gjendje ekzistuese të demtuar, i prerë dhe i cveshur nga kurora e gjelbra (të mos priten për shëndetshme). Ky element ashtu si edhe guret kilometrike tregojnë informacion gjatë itinerarit për alpinistët. Informacioni është orientues, dhe tregon informacion të tipit: lartësi topografike dhe maja, drejtimi nga duhet të shkojë, elemente me rrezikshmeri në atë pikë etj..




Figura 68




Figura 69

2- Shkallare dhe ure druri

- Shkallarja propozohet ne dy variante. Varianti 1 propozohet per zona me pjerresi me te madhe dhe me te rrezikshme ne pyell.




Figura 70

- Varianti 2 propozohet per lehtesimin e pjerresive te vogla. Ku variant do te realizohet me elemente te pyellit duke ngelur brenda kontekstit te natyres.




Figura 71

- Ure druri

Ura propozohet te ndertohet me kostrukcion totalisht druri. Konstruksioni mbajtes i saj te realizohet nepermjet dy trungjeve . Mbi trungje te montohet shtrimi me derrasa pishe . Parapeti propozohet te realizohet me elemente teresisht natyror te zones ,dege druri te gjelberuar.




Figura 72




Figura 73

3-Litar Mbajtës

Propozohet vendosja e litarit mbajtës ne zonat me rrezikshmeri rreshqitjeje guresh ku ka edhe mungese te gjelberimit te larte. Ankorimi i nje stukture celiku cdo 1m ne gure do te sherbeje per kapjen e litarit.




Figura 74

4- Struktura druri ,tavolina dhe stola druri

Propozohen dy tipe strukturash druri te cilat do te sherbejne si zona strehimi per kalimtare. Kto struktura jane te dyja te mbuluara me shikulla dhe te veshura me derrasa ne tre ane.




Figura 75




Figura 76

- Propozohen dy variante stola + tavoline druri.

Varianti 1 perfshin nje tavoline rrethore druri me diameter 80cm fiksuar mbi nje trung qendror te zhytyr ne toke dhe dy stola drejtkendore me dimensione (40cm x150cm) fiksuar me gozhda mbi nje trung te vendosur horizontalisht.

Varianti 2 perfshin nje tavoline rrethore druri me diameter 80cm fiksuar mbi nje trung qendror te zhytyr ne toke dhe 7-te stola trugje druri me diameter 50cm. Stolat jane 45 cm te larte dhe 40 cm mbeshtetese druri.




Figura 77




Figura 78

5- Strukturekspozitor korteni

Struktura e kortenit propozohet ne gryken e Alpeve ne itinerarin Theth-Valbone. Struktura eshte propozuar korteni sepse eshte me rezistente ndaj agjenteve te forte atmosferike . Brenda struktures propozohet vendosja e maketit te majave me te larta duke filluar nga 800 m mbi nivelin e detit. Maketi do te mbulohet me xham te temperuar ,rezistent ndaj kushteve atmosferike.




Figura 79

6- Çezmë

Propozohet realizimi i cezmes me element natyrore dru dhe gure si ne vizatimin e meposhtem. Dukeqense ne Alpe ekzistojne burime me uje te paster dhe te ftohte qe buron direkt nga mali, eshte menduar stilizimi natyral i ktyre burimeve duke perdorur elementet e pyellit. Çezma do jete nje pike grumbullimi dhe pushimi per vizitoret.

Detaj i çezmës SH 1:20
Drinking fountain detail SC 1:20




Figura 80



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
N.6711/1


SHOQËRIA: "SON Engineering & Construction"			
DREJTUES	LIGJOR:	ERIND	BEJLERI
DREJTUES	TEKNIK:	ERIND	BEJLERI
ADRESA:		TIRANË	
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data:		13.02.2018	

NË PROJEKTIM

Kat.	1	c	Studime pjesore urbanistike.
Kat.	2	a	Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale – turistike - vepra arti në infrastrukturë.
		c	Projektim interiere.
		d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA




Shënim: Kjo liçencë është e vlefshme deri më datën 11.02.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

L I C E N C Ë
K.1024/1

MBIEMRI	PORO	
EMRI	ARTON	
ATËSIA	ANESTI	
DATËLINDJA	19.05.1978, Fier	
VENDBANIMI	TIRANË	
DIPLOMUAR, MË	2001	
TITULLI	Ing. Ndërtimi, Profili Strukturist	
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :		24.07.2017

NË PROJEKTIM

Kat.	3	a	Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
		b	Projektim: 1. Objekte civile – industriale – turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
		c	Projektim: 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton-arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.
		e	Projektim objekte civile e turistike prej druri.
Kat.	4	a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
		f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
Kat.	6	a	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
Kat.	7	a	Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10 m.
		b	Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA




Arton Poro



Digitally signed
by Arton Poro
Date: 2017.12.06
18:08:50 +01'00'



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
DHE TREGETISE
TREGETISE DHE SPERANARJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-2068-09-2016
NUIS/NIPT: L62113034E

LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: TIRANE, TIRANE, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize
Keko, Pallati Andi Konstruktion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Nënshkrimi i sportelit: *Florisela*

Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerje detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.

